

VENDIM
Nr. 453, datë 9.7.2014

**PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT
E NJERIUT, DATË 25.6.2013, PËR ÇËSHTJET
NR. 33192/07 DHE NR. 33194/07, “KAÇIU DHE KOTORRI KUNDËR SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 25.6.2013, për çështjet nr. 33192/07 dhe nr. 33194/07, “Kaçiu dhe Kotorri kundër Shqipërisë”, në shumën 15 600 (pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) euro, si dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat për dëmshpërblimin.
2. Vlera e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të konvertohet në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.
3. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë në emër të ankuesit, z. Olsi Kaçiu, në vlerë proporcionale me detyrimin që ka shteti shqiptar ndaj ankuesit, sipas vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 25.6.2013, për çështjet nr. 33192/07 dhe nr. 33194/07, “Kaçiu dhe Kotorri kundër Shqipërisë”.
4. Pagimi i shumës së depozituar sipas pikës 3 të këtij vendimi, në favor të ankuesit, z. Olsi Kaçiu, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit.
5. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.
6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama